



QENDRA KOMBETARE E CILESISE,
SIGURISE DHE AKREDITIMIT TE
REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSTITUCIONEVE SHENDETESORE
SHENDETESISE



CENTRAL EUROPEAN
EXPERT NETWORK

**KONFERENCA E PARE KOMBETARE
PER UDHEZUESIT E PRAKTIKES KLINIKE TE BAZUAR NE EVIDENCE
TIRANË, 10 - 11 MARS 2008**

Në analizën e problemeve të lidhura me Cilësinë e Kujdesit Shëndetësor, mungesa e udhëzuesve klinik të praktikës më të mirë është identifikuar si një ndër mangësitë e rëndësishme të sistemit tonë shëndetësor.

Ministria e Shëndetësisë ka ngarkuar QKCSA të koordinojë dhe të mbështesë formulimin e Udhëzuesve të Praktikës më të mirë Klinike.

Për këtë qëllim do të ndihmojë edhe një agjensi Austriake e përzgjedhur nga Banka Botërore me ekspertizë në këtë fushë. Natyrisht përmbajtja shkencore dhe profesionale e Udhëzuesve dhe rekomandimet e tyre do të duhet të formulohen nga profesionistët tanë më të shquar dhe me ekspertizë të lartë në fushën përkatëse.

Procesi i formulimit të Guidelineve do bëhet konform me rekomandimet më të fundit të OBSH-së, Komunitetit Europian dhe të Bashkimit Europian, në të cilat 2 elementë janë thelbësorë, ajo e mbështetjes së rekomandimeve në Evidencën Shkencore dhe e përfshirjes në proces të palëve të tjera të interesuara për Cilësinë e Praktikës Klinike.

Në këtë kontekst u mbajt me Dt. 10 - 11 Mars 2008, **KONFERENCA E PARE KOMBETARE PER UDHEZUESIT E PRAKTIKES KLINIKE TE BAZUAR NE EVIDENCE.**